



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRIN

02 No./Dr. 403/17  
No. llog./Bast. 2  
Data / Datum 04.04.2017  
VUSHTRRI - VUČITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS

Data e nënshkrimit të Marrëveshjes me Partecipim: 03.04.2017

KOMUNA E VUSHTRRIË

Rr. "Adem Jashari" nr.1, tel. 028 571 524

Duke u bazuar në nenin 17 pika a zhvillimi lokal ekonomik të Ligjit me Nr.03/L-040, si dhe Thirrjes për Aplikim të Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me Nr:09-007-11 të datës: 21.02.2017, lidhë këtë:

### MARRËVESHJE ME PARTICIPIM (Për projektin "Makina për Mbjelljen e Misrit")

#### E përpiluar në mes të:

1. Komunës së Vushtrrisë të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z. Bajram Mulaku në një rënë anë në cilësinë e subvencionuesit, dhe
2. Grupit të përfituesëve të projektit "Makina për Mbjelljen e Misrit" të cilën e përfaqësojnë me autorizim:
  - Rafet Haradinaj nga fsh. Stanoc i Epërm K-Vushtrri me Nr. personal: 1173932592
  - Sadullah Salihu nga fsh. Druar K-Vushtrri me Nr. personal: 1005302907
  - Adem Bala nga fsh. Dumnicë e Llugës K-Vushtrri me Nr. personal: 1013245203

#### Neni 1

##### Qëllimi

Qëllim i lidhjes së kësaj marrëveshje me participim është përkrahja nga Komuna e Vushtrrisë në ngritjen e cilësisë në prodhimtari.

#### Neni 2

Lënda e kësaj marrëveshje është participimi vullnetar i grupit të përfituesëve (të makinës së misrit) të Komunës së Vushtrrisë, lidhur me sigurimin apo grumbullimin e mjeteve financiare të përfituesëve për realizimin e projektit "Makina për Mbjelljen e Misrit" në bashkëfinancim me Komunën e Vushtrrisë si subvencionuese kryesor i projektit.

#### Neni 3

Vlera e përgjithshme e mjeteve që duhet grumbulluar nga participimi i përfituesëve për realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje me participim është në vlerën e përgjithshme prej 5.800 €.

#### Neni 4

4.1 Vlera e mjeteve që ka siguruar Komuna si investitor kryesor për realizimin e projektit lëndor është shuma prej 15,000.00 €, ndërsa që projekti të realizohet duhet që përfituesit të participojnë vullnetarisht me mjetet në vlerën e cekur në nenin 3 të kësaj marrëveshje.

4.2 Vlera e tërësishme e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje është 20,800.00€

#### Neni 5

##### Obligimet e Komunës

Komuna merr për obligim që me sigurimin e mjeteve nga përfituesit të bëjë realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje.

**Neni 6**

Në rast të mos grumbullimit të mjeteve Komuna do të bëjë stopimin e realizimit të projektit lëndor.

**Neni 7**

**Obligimet e përfituesit**

- 7.1 Përfituesi është i obliguar të paguajë shumën prej **1,160.00 €**, në llogari të caktuar bankare të Komunës së Vushtrrisë.
- 7.2 Përfituesi është i obliguar që të përmbahet marrëveshjes në përpikëri.
- 7.3 Përfituesit/et nuk i lejohet ta shesë, tjetërsojë ose ta keqpërdorë subvencionin, në të kundërtën do të ndiqet penalisht.

**Neni 8**

Për ekzekutimin e kësaj marrëveshje kujdeset:Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

**Neni 9**

Kjo marrëveshje ka tretmanin e kontratës vullnetare në mes të palëve dhe e njëjta do të realizohet me përmbushjen e obligimeve nga ana e të dy palëve.

**P A L Ë T E M A R R Ë V E S H J E S**

**Investitori:**

Komuna e Vushtrrisë  
z.Bajram Mufaku  
(Kryetar i Komunës)



**Përfaqësuesit e përfituesëve :**

- 1.Rafet Haradinaj
- 2.Sadullah Salihu
- 3.Adem Bala



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN

07 Nr./Br. 409/17

Nr. Iq./Enesi \_\_\_\_\_

Data: / Datum 05.04.2017

VUSHTRRI - VUČITRAN



Republika e Kosovës

Komuna Vushtri

Kryetari i Komunës

Në bazë të nenit 70 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr 03/L-149 dhe në bazë të nenit 9 të rregullores nr.04/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin civil, Kryetari i Komunës, bien:

### VENDIM

- I. Me të cilin vendim autorizohet komisioni disiplinor për shërbimin civil të Komunës së Vushtrisë që të i shqyrtojë edhe çështjet disiplinore për nëpunësit të cilët nuk janë shërbyes civilë, por janë pjesë e administratës komunale.
- II. Autorizimi vlen deri në përfundim të mandatit të komisionit disiplinor, në përbërje të tanishme.
- III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kopje: 1X1 Iliriana Azemi  
1X1 Albanez Tahiraj  
1X1 Branislav Vuksanoviq  
1X1 Zyrës së Personelit



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITAN

№ Nr./No. 449/17

№. Tëq./Dr. nr.

Data / Datum: 06.04.2017

VUSHTRRI - VUČITAN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës nr.000683, dt.27.03.2017, në shumë prej 38.00 € (tridhjetetë euro), për shpenzimet e krijuara - drekë me zyrtar të lartë nga Policia e Kosovës.
2. Pagesa të bëhet nga buxheti i Zyra e Kryetarit në llogarinë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës dhe nenin 17 paragr. 17.1 të Rregullores për Dhënien e Dekoratave 01nr.186/13, dt.25.07.2013, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M  
PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR DEKORATA

1. Me këtë vendim formohet komisioni për dekorata me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit, më 17 qershor 2017 në këtë përbërje:
  - 1.1 **Shpresa Rama**, kryetare e komisionit
  - 1.2 **Arta Haxhaj**, anëtare
  - 1.3 **Musaj Tërbunja**, anëtar
  - 1.4 **Abdullah Klinaku**, anëtar
  - 1.5 **Xhevrije Rama**, anëtar
2. Komisioni në fjalë do të shqyrtoj të gjitha iniciativat gjegjësisht propozimet për ndarje të dekoratave të cilat duhet të jenë të arsyetuara me shkrim. Në rast se ju mungon arsyetimi kryetari i komisionit do të ia kthej propozuesit për të dhënë arsyetimin me shkrim.
3. Komisioni bënë përzgjedhjen paraprake dhe i propozon listën e ngushtë Kuvendit të Komunës për miratim. Komisioni nuk mund të bëj më tepër se 10 propozime për mirënjohje për aprovim në kuvendin e komunës.
4. Kryetari i komisionit i arsyeton me shkrim dhe me gojë para anëtarëve të kuvendit.
5. Para përcaktimit për propozimet për dekorata, komisioni do të verifikoj nga lista e dekoratave nëse eventualisht ndonjërit nga të propozuarit iu është nda dekoratë në vitet paraprake.
6. Komisioni do të filloj me punë menjëherë në mënyrë që propozimet të përgatiten me kohë për mbledhjen e muajit maj 2017.
7. Komisioni përveç propozimeve për Ditën e Çlirimit në qershor të këtij viti, ka mandat edhe për raste tjera të dhënies së propozimeve për dekorata, brenda vitit 2017.
8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
9. Vendimi iu dërgohet: anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës  
**Pajram Mulak**



Komuna e Vushtrrisë



Islamic Relief – Kosova

## Marrëveshje bashkëpunimi

ndërmjet

**Islamic Relief Word Wide - Zyra në Kosovë (IRW)**

dhe

**Komuna e Vushtrrisë (Komuna)**

për realizim të projektit humanitar përmes së cilës përcaktohen kushtet mes **Islamic Relief World Wide zyra në Kosovë (IRW) dhe Komuna e Vushtrrisë (Komuna)** në lidhje me bashkimin e mjeteve/fondeve për projektin “**Vizita dhe ofrim i shërbimeve shëndetësore falas për banorët e Komunës së Vushtrrisë**” që është pjesë e projektit të IRW me pin. kod numër **020\_002187**.

### Neni 1.

#### Qëllimi i Marrëveshjes

1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të përcaktojë formën e bashkëpunimit mes IRW dhe Komunës me qëllim të implementimit dhe finalizimit të projektit që ka për qëllim ofrimin e shërbimeve shëndetësore me rastin e vizitave mjekësore nga ana e stafit shëndetësor, pa pagesë për të gjithë banorët e Komunës, me fokus në vizita në shtëpitë e tyre të lehonave dhe foshnjave, personave me aftësi të kufizuara, personave me sëmundje kronike si dhe personave të moshës së shtyrë me **pin kod 020\_002187** që implementohet nga ana e IRW.

1.2 Përfitues nga ky projekt do të jenë të gjithë banorët e Komunës së Vushtrrisë që llogaritet të jenë rreth 70,000 banorë. Prej tyre përfitues direkt janë:

- 1100 gra lehona dhe 1100 foshnje
- 5000 persona të moshës së tretë gra dhe bura
- 500 persona me aftësi të kufizuara
- 400 persona me sëmundje kronike

## **Neni 2.** **Përshkrimi i projektit**

2.1. Menaxhues i projektit është IRW në bashkëpunim me QKMF – Vushtrri, dhe participimi i komunës do të bëhet me anë të transferit të mjeteve të komunës në llogarinë bankare të IRW, pas dëshmive të faturuara të shpenzimeve dhe raportit të shërbimeve të ofruara për çdo muaj.

2.2. Procedurat e selektimit të mjekëve të cilët do të angazhohen për punë në teren do të organizohet nga IRW me komision për selektim të kandidatëve të caktuar nga IRW.

2.3. Monitorimin, organizimin si dhe raportimin për kuantitetin si dhe kualitetin e shërbimeve ta bëjë koordinatori/mbikëqyrësi i projektit i cili do të jetë në bashkëpunim të rregullt me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunë.

## **Neni 3.** **Obligimet e palëve**

3.1. Participimi financiar i IRW-së

3.1.1. Në kuadër të projektit me një pin kod **020\_002187**, IRW do të sigurojë pjesën e fondeve në vlerë prej € 20,000.00 (njëzet mijë euro) për implementim të këtij projekti ashtu si është paraqitur në Shtojca A të kësaj Marrëveshje.

3.2. **Participimi financiar i Komunës**

3.2.1. Në kuadër të buxhetit komunal Komuna do të participojë me kontribut financiar në shumën prej € 19,900.00 (nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind euro) për implementim të këtij projekti ashtu si është paraqitur Shtojca A të kësaj Marrëveshje.

3.2.2. Total vlera e projektit është € 39,900.00 (tridhjetë e nëntë mijë, e nëntë qind euro) derisa shpenzimet për shërbime do të bëhen sipas zërave që janë paraqitur në Shtojca A të kësaj Marrëveshje.

3.2.3. Komuna e Vushtrrisë, përmes QKMF-së menaxhon me kuadrin profesional të angazhuar si pjesë e projektit dhe vendos për mënyrën apo vendin e dhënies së shërbimeve në pajtim me shtojcën B.

## **Neni 4.** **Përgjegjësitë e palëve**

4.1. Është e kuptueshme nga të dyja palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje që çdo palë duhet të jetë e aftë për të përmbushur përgjegjësitë sipas kësaj marrëveshjeje Nëse në çdo kohë

Komuna nuk është në gjendje të kryejë funksionet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, Komuna menjëherë do të njoftojë Menaxherin e Programit për Kosovë të IRW si dhe e kundërta.

4.2 Të dyja palët bien dakord për të emëruar koordinatorët për zbatimin e suksesshëm të kësaj marrëveshjeje.

4.3 Koordinatorët do të jenë përgjegjës për rolet e institucionit të tyre dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

4.4. Personi kontaktues i caktuar nga Komuna pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje si dhe personi kontaktues i caktuar nga IRW pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje.

#### **Neni 5.**

#### **Numri dhe astete e angazhuara në projekt**

5.1. Numri i profesionistëve shëndetësor dhe teknik që do të angazhohen në projekt me qëllim të realizimit të suksesshëm të dhënies së shërbimeve shëndetësor është së paku 8 (tetë) persona, prej tyre:

- 4 (katër) mjek të përgjithshëm dhe
- 4 (katër) infermierë.

5.2. Në rast të mos plotësimit të numrit me mjek të përgjithshëm, zëvendësimi bëhet me staf infermierik.

5.3 Për dhënien e shërbimeve në teren do të ipet në shfrytëzim për këtë projekt një automjet nga ana e QKMF-së.

#### **Neni 6.**

#### **Koordinatorët**

##### **6.1. Koordinator për IRW**

Emri: Gazmend Gjota

Adresa: rr. Bajram Kelmendi, No. 10 / A,

Prishtinë, Republika e Kosovës

Zyra Telefon: 038 232 431

e-mail: [gazmend.gjota@ir-rks.org](mailto:gazmend.gjota@ir-rks.org)

##### **6.2. Koordinator për Komunë,**

Emri: Fisnik Kamberi

Adresa: QKMF – Vushtri

Telefoni: 044 235 294

Tel/Fax: 028 571 411

e-mail: [fisnikkamberi@hotmail.com](mailto:fisnikkamberi@hotmail.com)



## Neni 7.

### Gjuha zyrtare e Marrëveshjes

7.1 Gjuha që mbizotëron në këtë marrëveshje është versioni në gjuhën shqipe.

## Neni 8.

### Kohëzgjatja e marrëveshjes

8.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të Menaxherit të Programit për Kosovë të Islamic Relief World Wide Zyra në Kosovë dhe kryetarit të Komunës së Vushtrrisë dhe do të vazhdojë deri më 31 Dhjetor 2017 ku pritet edhe të përfundojë realizimi i projektit.

## Neni 9

### Mosmarrëveshjet

9.1 Në rast të ngecjeve të realizimit të projektit palët pajtohen që të bëjnë ndryshimin e kësaj marrëveshjeje për një periudhë tjetër me një aneks të ri të kësaj marrëveshjeje me shkrim dhe të nënshkruar nga të dyja palët.

Islamic Relief World Wide - Kosovo office (IRW)

Komuna e Vushtrrisë,

  
Ramadan Beqishi  
IRW Country Program Manager

  
Bajram Mulaku  
Kryetar

Data/ Date: 07.04.2017

Data/ Date: 07.04.2017

## SHTOJCA A

Përkujdesi shtëpiak për lehona dhe foshnjët, persona të moshës së shtyer, personat me sëmundje kronike dhe persona me nevoja të veçanta - 2017

Aktiviteti	Njësi/ muaji	Çmim në njësi	sherbimet	Kosto finale	%
Dhënia e shërbimve shëndetësore për qytetarët e komunës	8	€ 2,487.50	1	€ 19,900.00	50%
Sherbime infermierike	8	€ 330.00	2	€ 5,280.00	13%
Sherbime për koordinim/mbikeqyrje të projektit	8	€ 420.00	1	€ 3,360.00	8%
Sherbime për raportim	8	€ 100.00	1	€ 800.00	2%
Shpenzime financiare	8	€ 9.44	1	€ 75.52	0%
Fletushka vetedijesuese	8	€ 100.00	1	€ 800.00	2%
Telekomunikim	8	€ 30.00	1	€ 240.00	1%
Mirëmbajtja e vetures	1	€ 840.00	1	€ 840.00	2%
Asete për nevoja të projektit	1	€ 1,000.00	1	€ 1,000.00	3%
Kostoja e udhëtimit	8	€ 150.00	1	€ 1,200.00	3%
Barëra dhe material shpenzues	8	€ 375.56	1	€ 3,004.48	8%
Monitorimi	2	€ 200.00	1	€ 400.00	1%
Other IRW cost /kosto të tjera irw (financa, admin)	1	€ 3,000.00	1	€ 3,000.00	8%
<b>Kosto totale:</b>				<b>€ 39,900.00</b>	<b>100%</b>

## **Shtojca B.**

### **1. GRATË SHTATËZËNA DHE LEHONA**

**1.1. Kujdes Antenatal** - Përcaktim i shtatzënisë, përcjellja e shëndetit të gruas dhe zhvillimi i frytit. Kujdesi për një stil sa më të mirë të jetës, njoftimi i shtatzënësisë për shenjat e rrezikshme me qëllim të ofrimit të ndihmës adekuate. Parandalimi i abortit dhe lindjes së parakohshme

**1.2. Kujdes Postnatal** - Ka për qëllim të siguroj një shëndet dhe mirëqenie sa me të mirë për lehonën dhe të porsalindurin. Kujdesi për lehonën dhe mënjanimi i komplikimeve të pas lindjes përfshirë kontrollin e ndonjë infeksioni të mundshëm, depresionin postnatal si dhe hemorragjitë. Kujdesi në përgjithësi i shëndetit të nënës dhe fëmijës. Metodat dhe mjetet e planifikimit familjare.

**1.3. Kujdesi për të porsalindurin** - Adaptimi në jetën ekstrauterinë, fillimi i hershem i gjë dhënies, profillaksa e të porsalindurit, monitorimi i rritjes dhe zhvillimi i të porsalindurit, Njoftimi i të gjitha shtatzënave dhe lehonave për rëndësinë e ushqyeshmëris me qumësht të gjirit. Rëndësia e ushqyerjes ekskluzive në gjashtë muajt e parë të foshnjërisë. Të njoftohen të gjitha nënat për kohën dhe llojet e ushqimeve plotësuese adekuate. Zbulimi i ndonjë anomalie apo ngecje në zhvillim tek fëmijët.

### **2. KËSHILLIMI I GRAVE RRETHE MENOPAUZES**

Të njoftohen të gjitha gratë me ndryshimet që ndodhen në moshën e pre menopauzës, menopauzës dhe pas menopauzës.

### **3. MOSHA E TRETË MBI MOSHEN 65 VJET**

Zbulimi me kohë i sëmundjeve kronike dhe paaftësive të ndryshme. Adaptimi me moshën e tranzicionit dhe monitorimin e shenjave vitale.

### **4. PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

Përkrahja morale dhe emocionale, ndihma me mjetet e nevojshme p.sh. karroca për personat me paaftësi në lëvizje, llojet e patericave, këshillimi i familjes lidhur me kujdesin ndaj këtyre personave, ushqimi adekuat, higjienën dhe lëvizshmërinë e tyre për parandalimin e dekubitusit. Ofrimi i të gjitha shërbimeve të nevojshme p.sh. monitorimi i shenjave vitale, vlerat e glikemisë, aplikimi i terapisë së nevojshme medikamentoze. Për fëmijët me nevoja të veçanta, shfrytëzimi i potencialeve dhe aftësimi i tyre për vete kujdes. Zhvillimi i aftësive profesionale tek kjo kategori

e fëmijëve, përfshirja e tyre në shkollat e rregullta, ndërsa ata më pa aftësi më të rënda në shkollat special.

#### **5. PERSONAT ME SËMUNDJE KRONIKE**

Personat e kësaj kategorie kërkojnë kujdes dhe vëmendje të posaçme. Personat me sëmundje kronike p.sh. diabet kanë nevojë për këshillim rreth dietës monitorimet e vlerave të glikemisë, marrjes së terapisë me rregull dhe stilit të shëndetshëm të jetës me qëllim të parandalimit të komplikimeve më të shpeshta siç janë: neuropatit diabetike, retinopatite, nefropatite dhe kujdesi për shputë me qëllim të parandalimit të ulqeres diabetike.

Personat me HTA-këshillimi i këtyre personave për stil të shëndetshëm të jetës, zvogëlimi i përdorimit të kripës, aktivitetet e shtuara fizike, shmangia e pirjes së duhanit dhe alkoolit, evitimi i stresit. Monitorimi i rregullt i vlerave të TA si dhe përdorimi i rregullt i medikamenteve të përshkruara nga mjeku.

#### **6. PERSONAT ME SËMUNDJE MALINJE**

Këta persona kanë nevojë në mbështetjen e personelit shëndetësor në çdo aspekt qoftë në mbështetje emocionale morale dhe ndihmë profesionale. Personeli shëndetësor duhet të jetë në dispozicion në çdo kohë kur këta persona kanë nevojë.

#### **7. DHËNJA E NDIHMËS MJEKËSORE NË AKSIDENTE**

Dhënia e ndihmës së parë të lënduarve në aksidentet në komunikacion dhe aksidente tjera dhe përcjellja e të lënduarve deri në institucionin shëndetësor.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, nenin 21 të Rregullores së MF – Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 8 të Rregullës Financiare për Menaxhimin e Pasurisë Financiare të Komunës dt.464/14, dt. 20.03.2014, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M  
PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR VLERËSIM TË AUTOMJETIT ZYRTAR TË  
KOMUNËS

1. Me këtë vendim formohet Komisioni për vlerësim të automjetit zyrtar të komunës, targë 02Z-14-27, në këtë përbërje:
  - 1.1 Driton Dallku, kryesues
  - 1.2 Fatmir Shala, anëtar
  - 1.3 Arben Mlinaku, anëtar
2. Komisioni nga pika paraprake e këtij vendimi do të bëjë vlerësimin e gjendjes teknike të automjetit zyrtar të komunës, targë 02Z-14-27, prodhuesi Suzuki, tipi Vitara, viti i prodhimit 2000, nr. i identifikimit VSEETW03VNX202744 si dhe japë propozim nëse ky automjet është më e arsyeshme të regjistrohet apo i ipet Shkollës së mesme teknike "Lutfi Musiqi" për nxënësit e drejtimit automekanik për punë praktike.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi ju dërgohet: \_\_\_\_\_ anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

- Vë në gatishmëri resurset komunale që i kanë nën menaxhim për t'u përgjigjur kërkesave të administratorëve të platformës për gjendjen e kërkesave dhe ankesave të shtruara përmes platformës;
- Promovojë përdorimin e platformave tek drejtuesit e institucioneve komunale në mënyrë që të shërbej për ndërlidhje më të ngushtë me qytetarët aktiv të komunës.
- Të caktojë një zytar komunal si pikë kontaktuese për Demokraci Plus për realizimin e kësaj iniciative;
- Të sigurojë që zytarët komunal marrin pjesë në punëtoritë (sesione informuese mbi atë se si funksionojnë platformat) e paraparë nga Demokraci Plus.

Komuna e Vushtrisë dhe D+ pajtohen të mbajnë raporte konstruktive të ndërsjellët gjatë këtij bashkëpunimi dhe të respektohet pavarësia dhe paanshmëria politike e D+ si organizatë jo-qeveritare.

Ky memorandum do të hyjë në veprim në mënyrë të menjëhershme dhe të jetë efektiv për një kohë të pacaktuar. Memorandumi mund të amendamentohet në çdo kohë me pëlqimin e dy palëve, dhe në mënyrë periodike do të vlerësohen arritjet.

Kryetari i Komunës  
Komuna e Vushtrisë

Përfaqësuesi  
Demokraci Plus (D+)

Bajram Mulaku

Driton Selmanaj



Datë:

24.04.2017



Datë:

24.04.2017



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIŠË - OPŠTINA VUČITRA

QR N°/qir \_\_\_\_\_ **531/17**

No. i fq./faqet \_\_\_\_\_

Data/ Data \_\_\_\_\_ **26.04.2017**

VUSHTRRI - VUČITRA



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari


Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe propozimit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dt. 25.04.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Me këtë vendim formohet komisioni për shqyrtim të kërkesave për ndarje të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, në këtë përbërje:
  - 1.1 **Izet Miftari**, Menaxher i Bibliotekës së Qytetit
  - 1.2 **Shukrane Begu**, Menaxhere e Muzeut të Qytetit
  - 1.3 **Agim Gela**, Adminstrator në DKRS
2. Komisioni në fjalë do të shqyrtoj të gjitha kërkesat e adresuara në DKRS për ndarje të subvencioneve nga buxheti i kësaj drejtorie dhe jap propozime konkrete sipas rëndësisë dhe prioriteteve duke marrë në konsideratë njëkohësisht disponueshmërinë e mjeteve të kësaj kategorie buxhetore në këtë drejtori.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

  
Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRA

W/Nr./Nr. 533 / 17

No. Ekip./Ekip. \_\_\_\_\_

Data/ Datum 26.04.2017

VUSHTRRI - VUČITRA



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

1. Me këtë vendim caktohen zyrtarët komunal të cilët do të merren me kërkesat, raportimet apo ankesat e qytetarëve për sa i përket kryerjes së shërbimeve komunale në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
2. Zyrtarët e komunës sipas fushave:
  - 2.1 **Shqipe Gashi**, ndriçimit publik, njëkohësisht kordinatore e grupit (tel.044/156413, E-mail: shqipe.n.gashi@rks-gov.net),
  - 2.2 **Islam Latifi**, komunikacionit dhe menaxhimin e mbeturinave,
  - 2.3 **Ramiz Maliqi**, dëmtimeve të rrugëve,
  - 2.4 **Imer Cecelia**, dëmtimeve të trotuareve rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve,
  - 2.5 **Fatmir Shala**, parkimeve ilegale dhe transportit publik,
  - 2.6 **Rasim Mlinaku**, ambientit, duke përfshi ndalimin e pirjes së duhanit në vende publike.
3. Zyrtarët e cekur në pikën paraprake të këtij vendimi duhet të jenë të gatshëm të pranojnë në çdo kohë informatat përmes koordinatorit të grupit, nga përfaqësues të OJQ "Demokracia Plus" lidhur me kërkesat, raportimet apo ankesat e qytetarëve për sa i përket kryerjes së shërbimeve komunale në territorin e Komunës së Vushtrrisë si dhe raportoj pa vonesë në OJQ e sipërcekur, lidhur me masat që janë ndërmarrë për të zgjidhur kërkesat apo ankesat e qytetarëve.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi ju dërgohet: Përfaqësuesit të OJQ "Demokracia Plus" zyrtarëve të sipërshtuar dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës  
Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VUSHTRISË - КОМУНА ВУШТРИ

Uz Nr. / No: 544/17

No. I sq. / Zn. et

Data / Datum: 28.04.2017

VUSHTRRI - ВУШТРИ



Telekomiti i Kosovës Sh.A.  
Kryeqendër, Prishtinë, R.K.  
Tërbimë  
No./No. / No. : 01-1277/17  
Data/Datum: 10-05/17  
PRISHTINË, PRISHTINA, PRISTINA

Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo

### MARRËVESHJE

Mbi Shfrytëzimin e Kontratës Publike Kornizë për Ofrimin e Shërbimeve Telekomunikuese e Lidhur Ndërmjet Ministrisë së Administratës Publike (MAP) dhe Telekomit të Kosovës Sh.A.  
Numri i Prokurimit: 202-16-102-215

#### Pjesa I: Shfrytëzimi i Kontratës Publike Kornizë

1. Komuna e Vushtrrisë; Adresa : sheshi „Hasan Prishtina “ nr 173 Vushtrri ; Nr. Regjistrimi:.....; Nr. Fiskal: 600535001; Nr. TVSh : 330170580 N/A; Xhirologjaria 1000650310000041 dhe Banka:NLB.nëVushtrri .; të cilën e përfaqëson Bajram MULAKU , Kryetar i Komunes , (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

Dhe

2. Telekomiti i Kosovës Sh.A.; Adresa: Dardania P.N., 10000 Prishtinë, Kosovë; Nr. Regjistrimi: 70280741; Nr. Fiskal: 600016762; Nr. TVSh: 330079964; të cilën ligjërisht e përfaqëson z. Agron Mustafa, Drejtor Menaxhues i Telekomit të Kosovës Sh.A., (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër,

Janë pajtuar, që duke u bazuar në Nenin 1 (Pjesa I e Kontratës Publike Kornizë), të lidhin këtë Marrëveshje mbi Shfrytëzimin e Kontratës Publike Kornizë për Ofrimin e Shërbimeve Telekomunikuese në vijim:

**"Shërbimet -Telefonike mobile, internet, internet per GPRS, kabli Optik, shërbimet e telefonis fikse, shërbimet TV- kabllovik"**

Palët përmes nënshkrimit konfirmojnë pajtueshmërinë e tyre të plotë me lëndën e kësaj kontrate publike kornizë, dokumentet e saj përbërëse, duke përfshirë kushtet, çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve.

Pagesa e faturave të krijuara në baza mujore bëhet nga Komuna e Vushtrrisë, duke u bazuar në produktet dhe shërbimet e përzgjedhura telekomunikuese.

Marrëveshja hynë në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dyja palët dhe bëhet pjesë përbërëse e Kontratës Publike Kornizë, e cila duke u bazuar në Nenin 1.4 (Pjesa I e Kontratës Publike Kornizë), ka kohëzgjatje prej tridhjetegjashtë (36) muajve, duke filluar prej 01/05/2017 e deri më 30/04/2020.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në Gjuhën Shqipe në katër origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe dy origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Kontratë për Shërbime - Procedurë e Negociuar - Numri i Prokurimit: 202-16-102-215  
Titulli i Kontratës: "Shërbimet -Telefonike mobile, internet, internet per GPRS, kabli Optik, shërbimet e telefonis fikse, shërbimet TV- kabllovik"

## Pjesa II: Implementimi i Ofertës për Telefoni Mobile Klubi IRK

Palët, duke u bazuar në Nenin 1.2 (Aneks Nr. 1, Oferta Financiare, Pjesa IV e Kontratës Publike Kornizë), përcaktojnë kushtet për implementimin e marrëveshjes/ofertës Klubi IRK:

- Kjo marrëveshje/ofertë shfrytëzohet nga Komuna e Vushtrrisë.
- Kërkesa për shfrytëzimin e kësaj marrëveshje/oferte nga Komuna e Vushtrrisë është bërë zyrtarisht përmes MAP-it, ndërsa faturimi dhe pagesa e faturave të krijuara në baza mujore bëhet nga Komuna e Vushtrrisë, duke u bazuar në pakon e përzgjedhur postpaid-prepaid dhe vlerën e mbushjeve të Vala.
- Numri i anëtarëve (përdoruesve mobil postpaid dhe prepaid) në Klub (CUG) të Komunës së Vushtrrisë është 1584.00 me mundësi ndryshimi
- Komuna e Vushtrrisë shfrytëzon Paket Postpaid të prezantuara në ofertë që përcaktohet si vlerë e garantuar e faturës mujore
- Numrat Prepaid (anëtarët në CUG) kreditohen/ngarkohen së paku me 2.00 Euro me TVSh mbushje elektronike në baza mujore për thirrje jashtë Klubit (CUG) të Komunës së Vushtrrisë, e cila do të ruajë statusin aktiv të tyre për 31 ditë, me përjashtim të Numrave Prepaid (rasteve) për të cilët palët merren vesh që kjo ngarkesë të jetë 0.00 Euro, duke u bazuar në pakon e përzgjedhur postpaid-prepaid dhe vlerën e mbushjeve të Vala.
- Numrat Prepaid me ngarkesë 0.00 Euro për të realizuar thirrje duhet të ruajnë statusin aktiv duke kredituar llogarinë së paku me 2.00 Euro me TVSh mbushje elektronike në baza mujore për thirrje jashtë Klubit (CUG) të Komunës së Vushtrrisë, e cila do të ruajë statusin aktiv të tyre për 31 ditë.
- Numrat Prepaid, me kërkesë zyrtare, ngarkohen me Data Paket (Internet 3G/4G) Mujore për Prepaid, sipas tarifave të prezantuara në ofertë.
- Numrat Prepaid që nuk ngarkohen me Data Paket (Internet 3G/4G) Mujore për Prepaid mund të blejnë Data Paket (Internet 3G/4G) sipas tarifave dhe afateve të rregullta të përcaktuara nga TK-Vala.
- Komuna e Vushtrrisë furnizohet me mbushje elektronike ose kartela gërvishetese (scratch card) të Vala në baza mujore në vlerë 1,815.00 Euro me TVSh, që përcaktohet si vlerë e garantuar e faturës mujore me mundësi ndryshimi
- TK-Vala aplikon zbritje 20% (si zbritje në faturë ose për pajisje telefonike mobile ose për produkte/shërbime shtese) për Komunën e Vushtrrisë, në vlerën e garantuar të faturës mujore, e cila është gjithsejtë 1,815.00 Euro me TVSh (është përfshirë vlera e mbushjeve të Vala për Prepaid). Gjithashtu, TK-Vala aplikon zbritje 20% në pagesën fikse mujore për Paket e përzgjedhura Postpaid.

Kontratë për Shërbime - Procedurë e Negociuar - Numri i Prokurimit: 202-16-102-215  
Titulli i Kontratës: "Shërbimet -Telefonike mobile, internet, internet per GPRS, kablli Optik, shërbimet e telefonis fikse, shërbimet TV- kablllovak"

*Signature*

**Oferita e TK-Vala për MAP-IRK**

Klubi IRK Postpaid-Prepaid										
	IPK 1	IPK 2	IPK 3	IPK 4	IPK 5	IPK 6	IPK 7	IPK 8	IPK 9	IPK 10
	Çmimi me TVSH	Çmimi me TVSH	Çmimi me TVSH	Çmimi me TVSH	Çmimi me TVSH	Çmimi me TVSH	Çmimi me TVSH	Çmimi me TVSH	Çmimi me TVSH	Çmimi me TVSH
Numri minimal i anëtarëve në Klub	0.00 €	4.95 €	9.95 €	14.95 €	19.95 €	24.95 €	29.95 €	34.95 €	39.95 €	49.95 €
Tarda e Kyles (në herë) në TV-SH	0	50	200	300	500	700	1000	1500	2000	3000
Pjesëta mujore për anëtarë me TVSH	0	50	200	300	500	700	1000	1500	2000	3000
Numri minimal i shërbimeve prepaid	0.01 €	0.01 €	0.01 €	0.01 €	0.01 €	0.01 €	0.01 €	0.01 €	0.01 €	0.01 €
Thirrjet brenda Klubit (CUG)										
Valutimi/										
IPK1, 03 & 2 Muhurim										
Bujeti IRK TVSH										
Figjeli tjera IRK Konteste/IRK										
SKS ne Vala dhe Konteste										
SKS Interaksional										
Internet 3G/4G 1000 MB pakë mujore prepaid										
Internet 3G/4G 2000 MB pakë mujore prepaid										
Internet 3G/4G 5000 MB pakë mujore prepaid										
Internet 3G/4G 10000 MB pakë mujore prepaid										
Internet Pay as u Go TVSH me 100KB										
Çmimet për Postpaid-Prepaid jashtë Pakos dhe Klubit (CUG)										
0.01 €										
0.01 €										
0.01 €										
0.01 €										
0.02 €										
0.10 €										
2.00 €										
2.00 €										
4.00 €										
5.00 €										
6.00 €										
0.01 €										



Kontratë për Shërbime - Procedurë e Negociuar - Numri i Prokurimit: 202-16-102-215

Titulli i Kontratës: "Shërbimet -Telefonike mobile, internet, internet per GPRS, kabli Optik, shërbimet e telefonis fikse, shërbimet TV- kabllorik"

Te dhëna tjera:	
Tharjet Njër-kombetare	Siç më lart
Tharjet ne roaming	Siç më lart
FrF	JO
Koha Peak, OffPeak dhe Extra OffPeak	JO
CUG Postpaid-Prepaid	JO
CUG SMS	JO
Minuta kombetare	Të larta dhe mobile

**Të Dhëna Shtesë:**

- Të gjitha çmimet janë në Euro (€) dhe me TVSh.
- Pako Postpaid IRK 1 sipas kërkesës mund të përmbajë 2000 MB Internet 3G/4G me çmim 2.95 Euro me TVSh në muaj.
- Pikë e dedikuar kontakti 24/7.
- Kujdesi dhe mbështetja teknike 24/7.

<b>Për Autoritetin Kontraktues:</b>	
Emri:	BAJRAM MULAKU
Pozita:	KRYETAR I KOMUNES VUSHTRRIS
Nënshkrimi:	
Data:	28.04.2018
Vula:	

<b>Për Ofruesin e Shërbimeve</b>	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	28.04.2018
Vula:	

Kontratë për Shërbime - Procedurë e Negociuar - Numri i Prokurimit: 202-16-102-215  
 Titulli i Kontratës: "Shërbimet -Telefonike mobile, internet, internet per GPRS, kablli Optik, shërbimet e telefonis fikse, shërbimet TV- kabllorik"

